



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

### Nr. 66 Vendimi

Tiranë, më 28.09.2018

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesuese
<b>Roland Ilia</b>	Anëtar
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Relatore

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore znj. Anisa Duka, pas shpërndarjes së çështjes dhe caktimit të kryesuesit dhe relatorit, sot, më datë 28.09.2018, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

### **Z. Genci Sinjari – Gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës**

**BAZA LIGJORE :** Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Nenet 14 dhe 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

### **I. RETHANAT E ÇËSHTJES**

Subjekti i rivlerësimit, **z. Genci Sinjari**, gjatë periudhës së rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit dhe atë të kryetarit pranë **Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës**. Për shkak të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Me shkresën protokolluar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me nr. 1651 prot., datë 02.05.2017, me lëndë “Kërkesë”, **z. Genci Sinjari** ka paraqitur dorëheqjen nga funksioni i gjyqtarit dhe kryetarit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Në vijim, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, pasi mori në shqyrtim këtë kërkesë, vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes së gjyqtarit, mbështetur në nenet 63, 64 dhe 160, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Me shkresën nr. 2499 prot., datë 10.09.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. 5978 prot., datë 10.9.2018, Këshilli i Lartë i Drejtësisë i ka vënë në dispozicion Komisionit vendimin nr. 28, datë 9.5.2017, me të cilin është vendosur deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit dhe të mandatit të kryetarit të gjykatës, për shkak dorëheqjeje, të gjyqtarit Genci Sinjari.

## **II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen:

*“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.*

*2. Subjekti i rivlerësimit, që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.*

Me paraqitjen e dosjes, Komisioni është vënë në dijeni të dorëheqjes së subjektit Genci Sinjari “nga funksionet e magjistratit” dhe me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për mbarimin e këtij statusi.

Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeht Kushtetuta për dorëheqje. Kjo sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Genci Sinjari, është ndërprerë.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës të subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit.
4. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 28.09.2018.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**XHENSILA PINE**

**Kryesuese**

**GENTA TAFA (BUNGO)**

**Relatore**

**ROLAND ILIA**

**Anëtar**

**ANISA DUKA**

**Sekretare gjyqësore**